



TIPARET E SHËRBIMEVE

Sfera: Urbanizëm

Data e shpalljes së sqarimit: 05.05.2008

**PËRPUNIM PLANI URBANISTIK JASHTË VENDBANIMI
(me kërkesa të hartuara sipas nevojave të personave të
interesuar fizik dhe juridik)**

BAZA LIGJORE
Ligji për rregullim hapsinorë dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr.51/2005 dhe 137/07)
VENDI I DHËNIES SË DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME:
Arkivi i Komunës Çashkë rruga „Ilindenska 8” Lagja Çashkë Suzana Kostovska – Referent i pavarur për punë zyre dhe arkivi 043 241 400
KOHA PËR DHËNIEN E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME:
Çdo ditë pune prej ora 8:00 deri në ora 16
SEKTORI DHE PERSONI PËRGJEGJËS:
Sektori për urbanizëm, veprime komunale, komunikacion dhe mbrojtje të ambientit jetësorë Emilija Spirovska – Këshilltarë-arkitekt për planifikim urbanistik 076 42 68 37; 043 241 400
LISTA E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME:
<ul style="list-style-type: none">- KËRKESË në të cilën do të jetë e sqaruar ideja për investim në komunë, dmth nevoja e ndërtimit të një objekti me kërkesë konkrete programore, në lokalitet i cili gjendet jasht përfshirjes së planeve egzistuese urbanistike- Kopje të planit të katastrit (e kufizuese dhe jo më e vjetër se 6 muaj)- fletë pronësie (origjinale dhe jo më e vjetër se 6 muaj)- tregues grafik të lokalitetit dhe rrethit më të gjërë- dokument për veprimtari të regjistruar nga regjistri qendror i RM me të dhënat e firmës
KOMPENZIME:
<ul style="list-style-type: none">- Taksë administrative në vlerë prej 50 denarë për të parashtruar kërkesë Në xhiro-llogarinë vijuese: <u>Emri i marrësit: Ilogaria e kasafortës, buxheti i komunës Çashkë</u> <u>nr. i xhiro-llogarisë 100000000063095</u> <u>depozitues: Banka popullore</u> <u>Ilogaria e paguar: 840-171-03182</u> <u>shifra e të hyrave: 722315</u> <u>programi: 00</u> Qëllimi i pagesës:taksa administrative
KOHA E NEVOJSHME PËR SHQYRTIM:
15 ditë pune nga dita e dorëzimit të kërkesës.
NUMRI I KOPJEVE TË DHËNA:
1 kopje të përgjigjes me shkrim se e pranon idenë e propozuar.
PROCEDURA PËR ANKESË RRETH VENDIMIT:
Nëse përgjigja nuk jepet në afatin ligjorë, parashtruesi i kërkesës mund të dorëzojë ankesë drejtuar komunës. Për dorëzim të ankesës paguhet taksë administrative prej 50 denarë.
ME RËNDËSI

1. Kycja e planit urbanistik jasht vendbanimi do të pranohet në programin vjeturë të komunës vetëm nëse vlersohet se kërkesat programore dhe qarqet e personave të interesuar fizik janë të pranueshme për komunën.

2. Pas pranimit të idesë së propozuar, komuna zyrtarisht i dërgon kërkesë Ministrisë për urbanizëm dhe rregullim hapsinorë për dhënie të KUSHTEVE PËR PLANIFIKIM HAPSINOR. Pas koordinimit të kryer MAJPH ndërmjet komunës dhe agjencionit për planifikim hapsinor, personi i interesuar fizik do të ftohet që të nënshkruaj marrëveshje për përpunim të kushteve.

3. Shpenzimet e përpunim të Kushteve për planifikim hapsinor (në pajtim me çmimoren e Agjencionit) i bart personi i interesuar fizik ose juridik.

4. Pas marrjes së kushteve për planifikim të hapsirës, personi i interesuar fizik ose juridik angazhon firmë

projektuese e cila posedon licencë për përpunim të planeve urbanistike. Shpenzimet për përpunimin e PLANIT URBANISTIK JASHT VENDBANIMI (në pajtim me çmimoren e firmës së angazhuar projektuese) i paguan personi i interesuar fizik ose juridik. Afatin për përpunim të planit e cakton firma projektuese.

5. Personi i interesuar fizik ose juridik është i obliguar të finansojë edhe përpunim të bazës së azhuruar gjeodeske, e përpunuar nga firmë e autorizuar për punë gjeodeske, në afat të cilit e caktojnë ato.

6. Komuna zyrtarisht i dorzon kërkesë Ministrisë së bujqësisë, pulltarisë dhe ujrave për LEJE për ridestitim të tokës punuese e cila është e përfshirë në kufjtë e përfshirjes së planifikuar të planit urbanistik jashtë vendbanimi i cili përpunohet.

7. Procedura e mëtutjeshme për sjellje të planit urbanistik sipas ligjit, rrjedh në dy faya edhe atë të projektit dhe propozim fazën.

Pas përpunimit të PROJEKT PLANIT firma e licencuar projektuese urbanistike kryen revizion profesional (shpenzimet për këtë i paguan personi i interesuar fizik ose juridik) dhe kërkohet mendim i Ministrisë së transportit dhe lidhjeve (jepet në afat prej 15 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës), me ç'rast i dorëzohet Këshillit të Komunës së Çashkës për vërtetim. Rreth projekt planit organizohet PREZANTIM dhe ANKETË PUBLIKE (e cila zgjat së paku 10 ditë pune), për të cilën pregaditet raport.

Pastaj, përpunohet PROPOZIM PLAN i cili dorëzohet për të fituar LEJE prej ministrisë së transportit dhe lidhjeve (përderisa propozim plani nuk dorëzohet në afat prej 6 muaj nga marrja e mendimit rreth projekt planit procedura e sjelljes së planit do të përsëritet). Pas marrjes së pëlqimit, plani i dorëzohet Këshillit të komunës për miratim.

8. Pas sjelljes së planit urbanistik jashtë vendbanimi nga Këshilli, mund të fillojë procedura ligjore për dhënia e LEJES PËR NDËRTIM të objektit përkatës të personit të interesuar fizik ose juridik.